



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-2368/1 të datës 01.07.2021. kundër gjykatësit ----- nga Gjykata Themelore Civile Shkup 2, HIDHET POSHTË.

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, bëhet fjalë për pretendime nuk ka elemente për veprim kompetent të një organi tjetër kompetent, në rastin konkret Këshilli gjyqësor i RMV-së.

Lënda me numër 12-2368/1 të datës 01.07.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 01.07.2021, është dorëzuar njoftimi për veprimin e gjyqtarit ----- nga Gjykata Themelore Civile Shkup 2 dhe është formuar lënda me numër 12-2368/1 të datës 01.07.2021.

Në denoncim, parashtruesi i kërkesës thekson se në Gjykatën Themelore Civile të Shkupit zhvillohet procedurë gjyqësore në të cilën paditësit paraqiten si ----- dhe ----- nga Shkupi, dhe si i padituri është ----- nga Shkupi në bazë të konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës dhe përcaktimit të së drejtës së pronësisë. Sipas pretendimeve nga denoncimi, gjyqtari gjatë procedurës ka kryer disa parregullsi lidhur me marrjen në konsideratë të provave të paraqitura nga të dyja palët, për çka vihet në dyshim paanshmëria e gjyqtarit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent për rastin në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, duke pasur parasysh se Këshilli Gjyqësor i RMV-së është kompetent për të vepruar sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar:
- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Nënkryetar,
Katica Nikolovska**

